



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **31.08.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit 01 – Nr.276/2009, të datës 02.07.2010,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ridestinimin e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 2021,
5. Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, kolegë kuvendarë, media dhe gjithë ju të pranishëm. Unë kam si propozim edhe një pikë shtesë të rendit të ditës, pasi siç dihet deri në fund të muajit qershor me vendim të mëhershëm për shkak të pandemisë, ky kuvend ka vendosur për lirim nga qiraja për të gjitha lokalet që janë pronë e komunës. Prandaj duke e parë situatën në të cilën jemi dhe vendimet e reja të qeverisë, që të gjitha kafiteritë apo lokalet mund të punojnë vetëm në hapësirat e jashtme, e faktikisht ata paguajnë qira mirëpo nuk ju mundësohet me punu, prandaj unë kërkoj që si pikë shtesë të futet lrimi nga qiraja mujore deri në fund të vitit 2021 të gjitha lokaleve, prona të Komunës si dhe për të gjitha tokat bujqësore që shfrytëzohen nga qytetarët e komunës së Rahovecit.

Kryesuesi – Faleminderit për propozimin z. Hoxha, mirëpo unë mendoj që për propozimin tuaj do të ishte mirë që për mbledhjen e radhës ta kemi dhe t'i kryejmë këto obligime dhe të kemi mundësi që t'i ndihmojmë

edhe bizneset, pasi edhe ashtu nuk do të kemi shume pika për mbledhjen e ardhshme dhe kështu është mundësi e mirë që ta kemi për mbledhjen e ardhshme që të kemi mundësi të përgatitemi për marrjen e këtij vendimi. Mirëpo si do që të jetë unë do ta qes ne votim propozimin tuaj por sot i kemi veç 5 pika edhe është pjesë e pakos prej qeverisë dhe atë sigurisht se do ti ndihmojnë tash bizneset.

Fehmi Hoxha – Unë vetëm dua që ta arsyetoj, sikur sot, sikur në mbledhjen e radhës është e njëjta dhe nuk jemi duke bërë politikë, pastaj a del qeveria me propozim, ekzekutivi apo një anëtar i kuvendit, kjo është interes i të gjithë qytetarëve pasi vërtet janë të gjendje shumë të vështirë të gjithë, kështu që nuk kemi nevojë për mbledhjen e ardhshme, propozoj që ta vëni në rendin e ditës dhe të kalojë ajo sot pasi është e njëjta si sot sikur mbledhjen e ardhshme.

Fatmir Iska – Përsëritet për të gjithë, Unë po mendoj se propozimi është ne rregull por ne do ta trajtojmë në seancën e ardhshme dhe besoj që pak para fundit të muajit do ta kemi si pikë të rendit të ditës dhe do ta diskutojmë, dhe sigurisht se duhet ta bëjmë një analizë se cilat janë ato lokale dhe cilat biznese do të lirohen edhe prej qirasë edhe prej shfrytëzimit të hapësirës publike para lokaleve që i kanë. Kjo do të përfshihet edhe ne pakon ekonomike të qeverisë dhe do ta diskutojmë bashkërisht dhe secili propozim i cili është i mirëseardhur ne interes të qytetarëve atëherë ne jemi pro kësaj dhe besoj që do të ishte më mirë për seancën e ardhshme dhe këtu kemi edhe drejtorin për ekonomi këtu dhe do ta bëjmë një analizë dhe pasqyrë më të saktë për të gjitha bizneset që do të i lirojmë. Kështu që nëse vendosim atëherë mund të vendosim për disa kategori dhe nuk do të mundemi me analizua gjendjen e përgjithshme dhe prapë të merremi në seancën tjetër, kështu që do të përgatitemi për seancën e radhës që t'i kemi të gjitha.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar, atëherë e qesim ne votim rendin e ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fehmi Cena – Përsëritet për të gjithë. Unë kam dy ndërhyrje ne procesverbalin nga mbledhja e kaluar, pikërisht e para, e përgjithshmja se nuk është i lekturuar dhe mungojnë pikat dhe presjet dhe kjo vërehet në këtë procesverbal, por, ju tani e dhatë arsyetimin se nuk është i lekturuar dhe po ashtu një ndërhyrje tjetër është tek diskutimi im në faqe 8, shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm të komunës së Rahovecit për vitin financiar 2020, ku thuhet: kur jemi tek pasqyrat financiare një shfrytëzim sa më racional në mënyrë që buxheti të shkojë në vendin e duhur aty ku ndikon drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së qytetarëve dhe duhet të jetë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, kështu që duhet të përmirësohet ky gabim teknik.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim ne votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asamblistë dhe gjithë ju të pranishëm. Unë kam dy pyetje, e para ka të bëjë me drejtorinë e bujqësisë përkatësisht me projektin e rrugëve fushore pasi qytetarët e fshatit Guri i Kuq më janë drejtuar me një kërkesë për rregullimin e një rruge fushore që quhet “Rruga e drurit” e cila është e gjatë afërsisht 3 km dhe kërkoj nga drejtori i bujqësisë që ta marrë me prioritet këtë rrugë dhe gjithashtu qytetarët nga fshati Vrajakë më janë drejtuar me kërkesë për rrugën e quajtur Sade e cila është rrugë fushore e cila është pothuajse e pakalueshme. Pyetja e dytë është për drejtorin e shërbimeve publike, pasi në hyrje të fshatit Bratotin janë disa familje që aktualisht nuk kanë qasje në rrjetin e kanalizimit dhe kërkoj nga drejtori i shërbimeve publike që të ndërmerr diçka që të ju mundësojë këtyre banorëve që të kenë qasje në rrjetin e kanalizimit.

Mirjeta Krasniqi – Përsëritet për ju kryesues dhe për të gjithë kolegët këshilltarë. Pyetja ime ka të bëjë me DKA-në, pasi që u bë shtyrja e vitit shkollor për shkak të pandemisë, a keni mbledhur të dhëna se sa arsimtarë janë vaksinuar deri më tani dhe si qëndron gjendja e vaksinimit të personelit arsimor.

Faton Ramadani – Përshëndetje për të gjithë. Unë desha me diskutue rreth disa problematikave që po na preokupojnë neve ne fshatin Celinë, pra, çështja është tek riparimi i varrezave si kërkesë e kahershme e fshatit për me u riparua ato varreza pasi me te vërtet kanë qenë në gjendje shumë të keqe, mirë që ka fillua me u punua nga komuna mirëpo nuk e kemi të qartë pasi qysh në pranverë kur kanë fillua punimet menjëherë pas një periudhe janë ndërprerë punimet dhe deri me tani kanë mbetur në gjendje shumë të keqe dhe nuk e dinë familjarët se ku ekzistojnë varrezat. Po ashtu kërkesë tjetër është nga qytetaret e fshatit për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik e sidomos te lagjes 17 shkurti, që është një lagje e madhe, pasi në fillim kanë pasur problem me rrjet elektrik për disa shtëpi në atë lagje që nuk kanë pasur rrjet, mirëpo tani kanë dalë me kërkesën e ndriçimit publik. Po ashtu tek drunjtë dekorativ është bërë një punë e mirë dhe që është shumë e rëndësishme për secilin fshat mbjellja e drunjve dekorativ mirëpo drunjtë që janë mbjellë ne fazën e fundit 60-70% e tyre kanë tharë dhe nuk e di se kush mban përgjegjësi për tharjen e këtyre drunjve. Gjithashtu edhe përroi në fshatin Celinë që është ndërtuar para 3 vite, kryetar, nuk e di sa jeni në ngjarje por ai përrua është dëmtuar, pra, punët që janë bërë para 3 viteve janë dëmtuar, pra 177,000 euro që janë investuar aty, lirisht mund të them se ka qenë investim i kotë, kështu që dikush duhet me mbajtë përgjegjësi për punën që është bërë. Kështu që kisha kërkuar ndonjë informatë rreth dëmtimit të kësaj përroske.

Munib Durguti – I nderuari kryesues, kryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblastë, media dhe gjithë ju të pranishëm. Në fillim pas disa shqetësimeve që i kanë shpreh qytetarët e lokaliteteve në Xërxë dhe Krushë të Madhe, po dua me marr një informatë nga qeveria lokale përkatësisht drejtorisë përkatëse për dy rreth rrotullimet që kanë qenë projekte të ministrisë në Xërxë dhe Krushë të Madhe, kështu që deri në cilën fazë kanë mbërri ato punime edhe pse shohim se në terren nuk është punuar përveç se një shtyllë që është vendosur në Xërxë kurse në Krushë të Madhe nuk është punuar asgjë. Kështu që qytetarët po kërkojnë ndonjë informatë se a do te vazhdojnë këto projekte apo si do te jetë fati i tyre, e sidomos ka ankesa prej lokalitetit në Krushë pas dhënies se lejes që i është dhënë nga komuna operatorit Viva-fresh Store dhe aty është krijuar një tollovi jashtëzakonisht e madhe ku mungojnë shenja në rrugë edhe kyçja në rrugën magjistrale është vështirësuar edhe me tej, kur kemi parasysh se mungon rreth rrotullimi i cili kishte me rregullua komunikacionin në atë zonë. Pastaj, shqetësimi i dytë është në shëndetësi, prej fillimit e kam pa si gabim caktimin e lokalitetit për vaksinim projekti në qendrën e dializës që komuna ka investuar aq shumë bashkë me partner dhe donator, pasi është caktuar një lokalitet i papërshtatshëm sepse është i ngushtë dhe shohim shume kolona të qytetarëve që krijojnë tollovi prej pa përshtatshmërisë së objektit shohim që po rrezikojmë që aty pq krijohet një burim i infeksionit e jo veç të vaksinohen ashtu si duhet dhe gjithashtu në anën tjetër ky caktim i këtij lokaliteti e pengon zhvillimin e qendrës së dializës, pasi qendra e dializës është vendos prej shtetit, ministrisë, Shërbimit Spitalor Klinik Universitar dhe tani është në rivendosje dhe aty pritet vetëm një vendim formal prej drejtorit të SHSUK-së në bazë të informatave që i kemi dhe nuk do të ishte mirë që komuna me e pengua këtë qendër duke e caktuar këtë qendër në qendër të vaksinimit. Pra, do të ishte mirë që të boshatiset ai objekt dhe të caktohet shtëpia e kulturës apo një objekt më i përshtatshëm që i plotëson kushtet për vaksinim.

Fehmi Hoxha – Unë kam dy pyetje, që njëra po përsëritet gati çdo muaj për çështjen e rrugës Fahredin Hoxha deri ku ka mbërri dhe a është nënshkruar kontrata dhe a është ne procedurë, pasi kryetari ka premtuar edhe vitin e kaluar mirëpo kaloj edhe ky vit e nuk shihet asgjë, pasi vërtet rruga është në gjendje të mjerueshme, edhe pse të gjithë e presin shiun me ra pasi është shumë i mirë për bujqësi kurse në çdo herë kur bjen shi ne nuk mundemi me jetua aty për shkak të kundërmimit shumë të madh që krijohet aty. Dhe çështja tjetër është pasi ne e dimë se është ne procedurë Sheshi i qytetit, disa faza kanë kaluar dhe është në procedurë. Mirëpo pyetja ime është se kur do te fillon ndërtimi i stadiumit te ri tek “Epopëja e UÇK-së” në parcelën që është ndarë nga ana e qeverisë në kohën e qeverisë së kaluar për ndërtimin e stadiumit të ri. Sigurisht se pa u ndërtua

stadiumi i ri nuk mund të fillohet kurrfarë procedure për ndërtimin e sheshit sepse së pari duhet të sigurohet stadiumi i ri e më pastaj të fillohet me ndërtimin e sheshit të qytetit.

Sali Sallteku – Përshëndetje për ju kryesues, kryetar dhe gjithë ju të pranishëm. Edhe me herët u parashtrua pyetja rreth vaksinimit të arsimtarëve që edhe unë desha me pyet se si qëndron çështja rreth vaksinimit të arsimtarëve por gjithashtu desha me ditë nga drejtori i arsimit, pasi sa kam dëgjua unë kane fituar paditë e drejtuar në DKA rreth çështjes së rrogave jubilarë, shujtave, pastaj pagesat e udhëtimit dhe dua të di nga ju që a keni bërë ankesë ju si drejtori?

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë desha me ja bo një pyetje drejtorit të shërbimeve publike ne lidhje me ndërtimin e 17 rrugëve në fshatin Ratkoc, ndoshta nuk është e nevojshme të përmenden dhe të ceken emrat e tyre, me sa e di këto rruge janë të kontraktuara mirëpo në punime ka ngecje. Nga mbledhjet e kaluara e kemi pare arsyetimin e kryetarit që për shkak të reshjeve punimet nuk kanë mundur te vazhdoen dhe tani po e pres një përgjigje nga drejtori me informata më të hollësishme se kur kanë me fillua këto punime dhe kur priten të përfundohen.

Shqipe Kryeziu – Pyetja ime i drejtohet drejtorit të shëndetësisë, se a keni fillua me pagesat për nënat lehonë dhe nëse keni filluar atëherë deri ku keni arritur pasi kemi disa shqetësime se nuk është bërë pagesa dhe nuk kanë marrë kurrfarë përgjigje dhe pyetja tjetër i drejtohet drejtorit të arsimit apo drejtorit të financave sa i përket rrogave jubilarë, shujtat kërkesat e mësimdhënësve, a doni me prit që me hije me përmbarues apo doni me u përgjigj për mësimdhënësit.

Kryetari – Faleminderit i nderuar kryesues, te nderuar anëtar te kuvendit, nënkryetar, drejtor te drejtorive, përfaqësues te mediave dhe gjithë ju te pranishëm. Të njëjtën pyetje e kanë parashtruar dy vet për çështjen e shujtave dhe pagesave te rrogave jubilarë dhe te udhëtimit. Pra e para ju informoj se qeveria nuk ka planifikuar mjete për me shtie ne buxhet për pagesën e shujtave edhe me zbatua kontratën kolektive sepse është një projekt që duhet te mbahet përgjegjëse cila do qeveri e sigurisht edhe kjo qeveri. Tash ne jemi te njoftuar me aktgjykimet e padive që i kanë parashtrua mësimdhënësit ne funksion te zbatimit te kontratës kolektive dhe sigurisht se do ti ndjekim procedurat ligjore dhe normalisht ne si komunë jemi te interesuar me realizua te drejtën mësimdhënësit tanë sa i takon zbatimit te kontratës kolektive edhe pse ne nuk jemi nënshkrues te kontratës kolektive dhe do te ishte mirë me dit edhe Shqipe Kryeziu edhe Sali Sallteku dhe te gjithë ne. Pra ministrja e arsimit zonja Arbërie Nagavci për kundër faktit që kryetaret e komunave kanë kërkuar që me u futë ne buxhet siç janë futë pagat jubilarë edhe po vazhdon procesi i pagesës se pagave jubilarë ashtu te futen edhe shujtat edhe pagesat e udhëtimit sepse kontrata kolektive është kontrate që e ka nënshkruar qeveria me sindikatën e arsimit dhe nuk e ka nënshkrua asnjë komunë dhe normalisht që komunat po e mbajnë barrën e gabimeve te qeverive tona. Por sido qoftë ne jemi ne biseda edhe me avokatin e komunës edhe me drejtorin e arsimit dhe drejtorin e financave që të na jepet sinjali i gjelbërt që te fillojmë me procedimin e pagesave te shujtave për aq sa kemi mundësi financiare për këtë vit dhe mos harroni për qdo pagesë që bëhet ne duhet ta kemi pëlqimin nga ministria e financave sepse nuk mundemi me bo pagesa edhe pse mund te kemi tepricë ne paga. Ne normalisht do ti shqyrtojmë rrugët ligjore dhe nuk jemi te interesuar që me pas veprime te cilat do ti kushtonin buxhetit te komunës se Rahovecit përmes përmbaruesve por sido që te jetë e themi përsëri se kanë te drejtë mësimdhënësit te kërkojnë ne realizimin në plotëni te kontratës kolektive mirëpo qeveria e ka hedhur barrën nëpër komuna dhe fatkeqësisht disa komuna kanë fuqi me te madhe dhe kanë ecur ne këtë drejtim me mirë kurse disa komuna kanë fuqi me te vogël financiare. Kështu që edhe komuna jonë është duke e përcjellë me vëmendje dhe do te shoh gjithë mundësitë edhe ligjore por edhe pëlqimin e ministrisë se financave që te kemi buxhet që te fillojmë me ekzekutimin e pagesave në qoftëse pa pasur nevojë me shkue te përmbaruesi. Pastaj pyetja tjetër e shtruar nga Fehmi Hoxha per çështjen e rrugës Fahredin Hoxha dhe kanalizimit, ne kemi pasur një memorandum mirëkuptimi për 12 rruge ne qytetin

Rahovecit i cili memorandum është anuluar në mënyrë të njëanshme nga ministria e infrastrukturës. Por unë nuk e kam pyet ministrin e infrastrukturës dhe e kam shpallë procedurën e prokurimit për shkak se kom dashtë dhe dua me mbajte zotimin para anëtareve të kuvendit e në këtë rast para anëtarit të nderuar të kuvendit z. Fehmi Hoxha. Mirëpo me rishikimin e buxhetit na i kanë lanë vetëm 10,000 euro të cilat pritet me i zotua ata mirëpo unë do të bëj të pamundurën që me i krye ato 12 rrugë pavarësisht sa i kemi në buxhet mirëpo nuk kom dashtë me ndalë procedurën e prokurimit sepse anulimi i memorandumit nga ana e ministrisë ka ndodhë pasi kanë filluar procedurat e prokurimit, pra na janë hequr 400,000 euro nga ministria e infrastrukturës dhe këtë është mirë me ditë edhe ministria e infrastrukturës. Mirëpo unë nuk do të ndalem dhe të vazhdoj punën në momentin kur hapen ofertat pavarësisht sa kam para në dispozicion operatorët të fillojnë punën ata që e fitojnë dhe lidhin kontratën me neve. Pra kjo është e vërteta dhe gjithashtu e vërteta tjetër është se unë pres që 3 vjet me fillua stadiumi i ri i përcaktuar në vendin e quajtur Epopeja e UÇK-së që është ndarë prona dhe kemi marr pronë nga qeveria e kaluar gjithsej 7 hektarë dhe e kemi bërë pronë të komunës për nevojat të ndërtimit të stadiumit në kompleksin sportiv. Nuk ka asnjë rezultat deri më tani pasi është në procedura të prokurimit sepse ka shumë ankese megjithëse në nuk kemi qasje sepse procedurat i zhvillojnë ata mirëpo në kemi marr informacione se puna ka shkuar gati njëjtë sikur e palestrës sportive „Mizahir Isma,“. Megjithatë unë pres që sheshi qendror i qytetit të fillojë këtë vit dhe jemi në prag të hapjes së qytetit edhe normalisht edhe sheshi qendror i qytetit qeveria e Kosovës përkatësisht ministria e ka anuluar memorandumin mirëpo do të vazhdojmë me forcat tona dhe me forcat e donatoreve dhe sigurisht se do ta bëjmë sheshin qendror të qytetit gjithashtu shpresoj që do ta rikthejë në fuqi memorandumin qeveria e Kosovës përkatësisht ministria e infrastrukturës dhe kam bisedua direkt me ministrin e infrastrukturës dhe nuk e di çfarë halli ka ai me komunat e Kosovës ai dhe cilido ministër dhe nëse punohet dikun në këtë vend atëherë me shumë se në komunat e Kosovës nuk punohet, edhe u deshtë që mos me i prekë komunat edhe pse jemi në pandemi, pasi kemi plot informacione ku ka pas mundësi me ju marr ndonjë ministrie ku ka teprica edhe me ju dhanë komunave ku po punohet. Pastaj pyetje e parashtruar nga Munib Durguti rreth nënkalimit në Xerxe dhe rreth rrotullimit në Krushe të Madhe ku prej kohës se ministrit Lutfi Zharku janë kontratat dhe njërin kontratë e ka RSM-ja dhe tjetrën e ka KAG asphalt dhe asnjëri projekt nuk ekzekutohet as sot e kësaj dite dhe definitivisht është projekt në përgjigjësi të infrastrukturës. Por vetëm e di që ka me bo përpjekje që me bo zgjidhje në nënkalimin në Xerxe por ka edhe disa probleme me pronat e hekurudhës edhe me shfrytëzuesit privat të atyre pronave, pasi unë kam bërë pyetje ish ministrin Lekaj se qysh ka mundësi me i dal qeverisë kundër bordi i hekurudhaye, pasi ju jep prona privateve kurse nuk ju jep shtetit me bo veprime të caktuara për një nënkalim apo rreth rrotullim. Ky problem ka mbetur peng dhe nuk e di edhe sivjet e keni në kod buxhetor përsëri pasi që nga koha e Lutfi Zharkut është në kod edhe ende janë paret dhe nuk ekzekutohet projekti edhe pse kontratat janë valide. Po ashtu e njëjta situatë është edhe të rreth rrotullimi në Krushe që nga koha e Lutfi Zharkut, ku kontraktues është KAG asphalt company dhe projekti ka mbetur peng për shkak të disa shqetësimeve të cilat i kanë krijuar hartuesit të projektit edhe ska mundësi me ekzekutua projektin dhe në kemi bërë revidim të projektit edhe pse nuk kishim të drejtë por kemi insistua që mos me i marr dikujt pronë kurse dikujt tjetër me i mbetur prona publike e pashfrytëzuar. Kështu që ka mbetur peng i mosveprimit të Ministrisë së infrastrukturës dhe në këtë rast nuk po e akuzoj në këtë rast askënd mirëpo zyrtarët e ministrisë së infrastrukturës mund të i pyetni dhe të merrni informata se pse nuk ekzekutohen për nënkalimin në Xerxe dhe gjithashtu pse nuk ekzekutohet kontrata rreth rrotullimi në Krushe. Rreth pyetjes së parashtruar nga z. Munib Durguti rreth mjedisit të vaksinimit, sot e patëm takimin e shtabit komunal emergjent. Kështu që e para në nuk kemi mundur me vendos në palestër sportive për shkak të aktiviteteve të tjera që kanë qenë të lejuara, pastaj me aplikimin elektronik me funksionimin praktik dallon për 100% dhe mos e harroni faktin se në qendrën e vaksinimit në Rahovec deri më tani me dozën e parë janë vaksinuar 26,660 persona për një afat rekord dhe me plot

përgjegjësi e them se asnjë komunë nuk është më mirë për vaksinim, kurse me dozën e dytë janë me pak për shkak të afateve mirëpo interesimi i qytetareve për vaksinim është i madhe. Kurse mundësin për me krijua ekipe shtesë nuk ka lejue ministria e shëndetësisë, pra ne veprojmë atëherë sa na lejon ministria e shëndetësisë në bazë të planit kombëtar të vaksinimit masiv. Kështu që herë pas herë janë krijuar tollovi për shkak se në njërin anë kufizimet dhe obligimet kanë pranua qytetarët për nevojën dhe domosdoshmërinë e vaksinimit kurse në anën tjetër interesimi në rritje nga frika e ka sjellë në situata të caktuara ku ka pasur tollovi dhe ku ka pasur nevojë edhe me ndërhyje ndonjëherë edhe policia për ruajtje të rendit. Pra ne qoftëse vaksinimi në një qendër kryesore të mjekësisë familjare në të vetmen qendër në komunën e Rahovecit sepse çdo komunë e ka një qendër dhe jo me shume pasi nuk na ka lejue ministria as neve dhe as komuna tjera, planifikohet që mesatarja duhet me qenë 400 vaksina në ditë kurse në një qendër siç jemi ne mbërrin deri 780 persona vaksinohen brenda ditës atëherë veç mund të paramendoni se çfarë vullneti, angazhimi dhe përkushtimi i stafit mjekësor të komunës tonë në QKMF. Pra janë të planifikuara 400 persona të vaksinohen brenda ditës kurse numri i të vaksinuarve mbërrin mbi 700 brenda ditës. Dhe nëse në kemi kërkuar prej ministrit të shëndetësisë që të na jepet mundësia me i hap edhe dy qendra të mjekësisë familjare për vaksinim për Krushe të Madhe dhe Ratkoc mirëpo ajo nuk na ka lejue, gjithashtu kemi kërkuar krijimin e ekipeve mobile me shkua me i vaksinue njerëzit që kanë nevojë të veçanta apo që janë në gjendje jo të mirë shëndetësore mirëpo përsëri nuk na ka lejuar ndonjëherë edhe bëjmë përjashtime edhe pa e pyet ministrin sepse nuk mund të i themi një plaku 80 vjeçar e jani në qendrën kryesore të mjekësisë familjare për vaksinim kur ka mundësi drejtori i QKMF-së Dr.Elunit Kryeziu shkon me ekipin e vet dhe e kryen vaksinimin në shtëpi. Sa i përket repartit të hemodializës, në mezi po presim me u hap repartit të hemodializës por nuk duhet ta harroni se nuk është faktor përcaktues hapja e repartit të hemodializës. Të gjithë ata që thonë se komuna e Rahovecit e ka një repart të mirë dhe i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret teknike me të gjitha paisjet edhe që po heziton komuna e Rahovecit atëherë e kanë gabim plotësisht dhe keteja them prej ministrit të shëndetësisë, drejtorit të SHSKUK-së, drejtorit spitalit rajonal të Prizrenit dhe gjithashtu ja kom vertetue me letra këtë. Unë jam gati në çdo moment me bo hapjen e repartit të hemodializës nëse ata e kërkojnë një gjë të tillë bashkë me drejtorin e shëndetësisë dhe drejtorin e QKMF-së, mirëpo ata e dinë me se miri pse nuk bëhet hapja e repartit të hemodializës, për ndryshe kemi komunikim institucional edhe me letra zyrtare dhe me protokolle në të gjitha qeverisjet si në kohën e qeverisë Kurti 1, pastaj në kohën e Avdullah Hotit dhe gjithashtu edhe në kohën e qeverisë Haradinaj, e tash edhe në kohën e qeverisë Kurti 2. Pra mezi po presim të bëhet hapja e hemodializës dhe menjëherë në e gjejmë vendin tjetër për vaksinim. Kështu që nuk e përjashtoj as je ministër të shëndetësisë që bashkë me institucione tjera të mjekësisë terciare SHSKUK-në dhe mjekësisë sekondare spitalin rajonal të Prizrenit nuk i kanë bo veprimet e nevojshme të pritshme nga ana e jonë për me instalua me funksionalizue dhe me bo për pacientet që janë me hemodializë dhe njëjtë situatë qëndron edhe sot e kësaj dite. Pastaj pyetja e parashtruar nga z. Faton Ramadani rreth drunjtëve dekorues, e dimë që për drunjtë dekorues ka përgjegjësi ai që ka kontratë me komunën e Rahovecit dhe unë nuk kam dëshirë me u thae asnjë dru dekorues mirëpo për çdo dru që thahet ka përgjegjësi kompania që i ka mbjellë dhe i mirëmban ato dhe krejt drunjtë do të zëvendësohen ato që nuk bëjnë të gjithë ata drunjtë që janë thae edhe sigurisht se në vjeshtë ka me vazhdua mbjellja e drunjtëve dekorues dhe krejt në pranverë do të shihet gjendja e përgjithshme e tyre. Pastaj tek varrezat, është e vërtetë që janë ndalua punimet mirëpo me 5 shtator rikthehen punimet në punishte nga operatori pasi arsyeja është e thjeshtë se nuk kemi pasur mjete financiare dhe ky është problemi dhe tjetër nuk ka sa i përket me operatorin, kështu që unë shpresoj që ky projekt të merr epilogun sa me shpejt sepse është edhe i nevojshëm dhe i domosdoshëm dhe e vërtetë që ka ngecje mirëpo ato janë pasojë e mungesës financiare. Po ashtu zgjerimi i ndriçimit publik është pjesë e kontratës dhe operatori momentalisht është duke punuar në Kramovik, Polluzhe, Hoçë e Brestoc dhe vazhdojmë në vendbanimet e tjera që na kanë mbetur edhe në mesin e

tyre është edhe Celina e posaçërisht për rrugën që ju e përmendet e me siguri ka edhe ndonjë rrugë tjetër që është nevojshme ndriçimi. Po ashtu edhe shtrati i përroskës, pra ka ndodh dëmtimi i niveletës në kohen e reshjeve dhe përmbytjeve që i patëm gjatë muajit Janar dhe kemi marr zotime nga operatori ekonomik që e ka krye punën dhe sigurisht se ai e ka krye punën mirë dhe kjo është e vlerësuar nga komisioni për vlerësim, tani atij i ka skaduar afati i garancisë mirëpo ai ka marr përsipër me krye dhe ju e dini se aty është një gypë i madhe i Radoniqit aty që ka shkaktua probleme dhe me sistemin e ujitjes nuk kemi mundur me bo ndonjë zgjidhje mirëpo ato pllaka që janë dëmtua aty janë pasojë e mbulimit me ujë që ndodhen gjatë muajit Janar. Kështu që kemi biseduar me Afrim Ibrahimin dhe jemi marr vesh që në kohen me të përshtatshme që me intervenua dhe i sanua ato dëmtime që janë shkaktuar nga vërshimet e mëdha të reshjeve të shiut. Rreth pyetjes e parashtruar për numrin e mësimdhënësve do të përgjigjet drejtori i arsimit z. Avni Morina. Pastaj procesi i rrugëve fushore është duk vazhduar dhe në kemi krye një mori të rrugëve fushore tash dhe janë 4 operator që janë duke punuar dhe janë krye disa rrugë në Xerxe, pasta në Fortesë, në Gexhe dhe është duke vazhduar në Vrajakë, Guri të Kuq dhe në shumë vendbanime tjera. Kurse sa i përket rrugëve lokale, operatori është rikthyer në punishte dhe po përpiket me të rregullua ato punë që i ka nisur që realisht edhe aty kemi pengesa pasi kemi shkurtim të fondeve që me një gjë të tillë përballen të gjitha komunat e jo vetëm komuna e jonë nga ana e qeverisë për shkak të pandemisë. Dhe kemi arrit që me bind që me punua në terrene dhe me i krye ato punë që i ka në kontratë si në Dejn, Vrajakë, Ratkoc dhe normalisht pastaj me vazhdua me rrugët tjera. Pra ashtu siç janë në kontratë edhe do të ekzekutohen dhe nuk mundem me fol për data për shkak se nuk është që kemi gjendjen me të mirë financiare në kategorinë e rrugëve lokale. Të kanalizimi në Bërdatin disa familje nuk kanë rrjet të kanalizimit mirëpo për një segment ka ndodh në këtë vitë rregullimi i kanalizimit dhe tash numri i shtëpive po zgjerohet që realisht janë ndërtuar sivejt dhe sigurisht se edhe për ato shtëpi do të bëhet zgjidhje kurse për rrugët fushore në Guri të Kuq dhe Vrajakë është duke shkuar operatori tash me radhë, kështu që brenda këtyre ditëve do të shkon në Malësi të Vogël dhe të vazhdon neper të gjitha vendbanimet pasi është një operator i fortë siç është Mendi-P që bën punën në mënyrën me të mirë të mundshme dhe gjithmonë nuk kursehet nga mundësit financiare që i ka apo nuk i ka komuna. Të gjitha shqetësimet janë reale që i keni ngritur këtu dhe gjithashtu e di që ka edhe plot shqetësime tjera që secili prej jush do të dëshironte me i ngritë, por edhe unë bashkë me ekipin tim do të jem vazhdimisht në dispozicionin tuaj për çfarëdo lloj sqarimi.

Sali Sallteku – Faleminderit kryesues, unë i kam thënë edhe me herët kryetarit se nuk është punë e qeverisë për këto mjete, por, është punë e komunës dhe kjo është e rregulluar me ligj dhe tash ju duhet me patjetër që duhet me krye këto punë pasi edhe ashtu kanë me t'i marr me përmbaues edhe pse ju nuk doni. Po ashtu e di që t'i kanë ndalë mjetet sepse nuk janë planifikuar ashtu siç duhet dhe sigurisht se edhe t'i kanë ndalë mjetet.

Kryetari – E vërtetë është se tash barrë po i mbesin komunave dhe në si komunë nuk jemi të pandërgjegjshëm dhe të pakujdesshëm, por ne do të provojmë që me krye punë dhe mos me shkua kjo çështje aty ku nuk duhet. Realisht e dini shumë mirë se kontratën e ka nënshkrua qeveria dhe krejt kjo ka shkua barrë e komunave dhe tash ne po provojmë me gjet zgjidhje. Po ashtu është e vërtetë se disa projekte janë nisur pa mbulesë financiare mirëpo unë prita që dikush prej juve pasi po e dojmë bujqësinë dhe jemi trevë bujqësore se pse dikush nuk pyeti se pse nuk po jepen subvencionet, pse nuk po aplikohet skema e granteve, pastaj ku janë 51 milion dhe nuk ja ka dhanë bujqësisë, atëherë pse nuk po ju jep komunave për infrastrukturë apo arsimit për mësimdhënësve. Atëherë nëse qeveria e kaluar e ka rrit për 2000 euro pagesën për subvencione për vreshta atëherë kjo të paktën ta kthen ashtu siç ishte 1000 euro dhe këto janë pagesa që i ka votue kuvendi i Kosovës në prag të shpërndarjes. Dhe tash thirrja për subvencione nuk u hap, skema për grante nuk po implementohet, pastaj rezultate nuk ka se kush janë përfitues pasi duhet të kemi përfitues nga komuna jonë shumë, pra 4,407,000 janë veç të komunës tonë nëse nuk i jep subvencionet e rregullta por nëse do të kishte dyfishua për

shkak te pandemisë atëherë do te ishin 8,814,000 euro i ka mangu komuna e Rahovecit vetëm ne bujqësi,. Kështu që pasi nuk po jep këto atëherë posë nuk po i jep nga dëmi i breshrit e te përmbytjeve, pasi gjithmonë ka ankesa për qeveritë e kaluara kanë qenë te këqija se kanë dhënë për dëmet nga breshëri apo nga përmbytjet apo për dyfishim te subvencioneve mirëpo kjo qeveri nuk e realizon asnjërën nga këto, pasi te gjitha ankesat e qytetareve sa i përket këtyre vinë dhe adresohen ne komunë. Mirëpo unë edhe nga ky kuvend komunal e ftojë qeverinë e Kosovës që me pas parasysh ankesat e qytetareve te Rahovecit që me i dhanë dëmet nga breshëri që me i kompensua pasi është vendim sepse edhe këta e kanë vendos me i kompensua dhe raportet ekzistojnë. Edhe me hap tash thirrjen për subvencione është shume vonë sepse edhe nëse e hap sivjet nuk ka mundësi teknike me u zbatua skema e pagesave direkte për shkak se vetëm vreshtat po mbesin, pasi qetash me u hap thirrja vetëm një muaj ka afat me aplikua, pas një muaji fillon shqyrtimi dhe komisionet duhet me dal pas muajit tetor dhe atëherë mundem me gjet vetëm toka te lëvruara edhe drunjtë dekorues. Pra pyetjet duhet me u bo edhe ne këtë drejtim dhe unë po e akuzoj qeverinë sepse unë po hije ne obligime, por nuk është e drejt një sheshe që është miratuar që nuk duhet te kishte lidhje se kush ka qenë ministër pasi është vendim qeverie dhe vendim i kuvendit te Kosovës për financimin e sheshit qendror te qytetit dhe tani kjo qeveri e anulon me arsyetimin se ska mbulesa financiare për shkak te pandemisë. Mirëpo unë do te mundohem që këto punë ti kryej vetë edhe e respektoj deri ne maksimum qeverinë time po r unë do te mundohem me i krye punët e mia si kryetar komune pasi kam marr mandatin nga qytetaret e komunës sime. Kështu te gjitha qeveritë kanë pasur konsideratë me ndihmën e ofruar mirëpo qeveria Kurti nuk po shpreh gatishmëri me na ndihmua askund dhe ky është një dallim që duhet me ditë anëtarët e kuvendit te komunës dhe qytetaret e komunës se Rahovecit. Kështu që nuk ankojem asnjëherë se qeveria nuk na ndihmon mirëpo vetëm ju them te vërtetën rreth kësaj. Gjithashtu për stadiumin që pyet dikush pse nuk po bëhet, duhet ta dini se është projekt i qeveris, gjithashtu edhe për nënkalim imin, për rreth rrotullimin është projekt i qeverisë, gjithashtu edhe për hemodilaizen është projekt i ministrisë shëndetësisë, SHSKUK-së, spitalit rajonal te Prizrenit. Po ashtu për rrugën Fahredin Hoxha është projekt që e kam nënshkrua me ministrin Abrashi memorandumin me vlerë prej 400,000 euro për 12 rruge kanalizime sinjalistike krejt këto ne qytet, mirëpo krejt këto projekte na janë hequr nga qeveria aktuale mirëpo unë do ti bëj me kapacitetet e mia mirëpo nuk do te bëj asnjëherë veprime ne mënyre te njëanshme me ju ndërpre kontratat apo memorandumet sikur po bëhen tash. Sido qoftë ne jemi ne pandemi dhe kushdo që vjen kryetar komune do te ishte me i ngritë këto çështje sepse qeveria është e jona, dhe nuk është e drejtë me ju marr dhe duke ju përgjysmua projektet, pastaj me qitë barrën kontratën kolektive gjithashtu për here te parë anashkalohet nga komiteteti anti covid komunat e Republikës së Kosovës që janë 38 komuna dhe sot asociacioni i komunave nuk ka mbajtur takim me kryeministrin dhe normalisht edhe unë i përgjigjem asociacionit te komunave.

Munib Durguti – Meqë mu dha fjala atëherë do të flas, z. Sali Sallteku nuk kemi asnjë keqkuptim dhe me asnjërin prej anëtareve tjerë pasi kemi bërë një rrugë të gjatë të bashkëpunimit qoftë si asamblist apo si drejtor atëherë, kështu që këshilla ishte me vend por edhe atje sa isha kam qenë i pavarur, por nuk e arsyeton mendimin e kryetarit që edhe ashtu kemi te drejtë me lëviz pasi secili e bën ne mënyrën e vet.

Sali Sallteku – I nderuar kryetar, them se qeveria duhet me patjetër me i dhanë mirëpo me mënyrën si the ti i kanë ndaluar mjetet dhe me fluksin e punëve që po i bëni tani sigurisht që edhe ju do të leni buxhetin e komunës me borxhe të shumta vetëm nëse jeni i sigurt se do e merrni prapë ju.

Ali Zhuniqi – Unë do ta kisha kuptuar kryetarin me arsyetimin e kritikave që i ka bërë mirëpo sjelljet e tregojnë te kundërtën, sepse nuk keni qenë i njëjti edhe në kohen e qeverive tjera, veç nëse ato kërkesa i ke bo dhe nuk kemi dëgjuar asgjë por tash hedhja e kritikave në drejtim të qeverisë dhe kundrejt ministrit Liburn Aliu në shkurtimin e investimeve kapitale dhe kundrejt Arbenit në lidhje me qendrat e vaksinimit, pasi ju e dini se këto janë kompetencat e ndara duke përfshirë prej ministrit të shëndetësisë, SHSKUK-së dhe qendrave

të mjekësisë familjare. Pra nuk është në rregull me bo tash kritika kur edhe qeveritë e kaluara kanë qenë njëjtë mirëpo nuk ke bërë të njëjta sjellje apo kritika.

Kryetari – Unë te them Ali Zhuniqi që te jemi korrekt dhe te singjertë çdo here ne salle te kuvendit sa here që ka qenë ndonjë problem që ka qenë kompetencë e qeverisë çdo here jam deklaruar dhe shume korrekt e kam thënë vazhdimisht dhe sigurisht edhe tani po i them te njëjtat që i kam thënë për çdo qeveri. Ndërsa i takon se a e kam kursye ndonjë qeveri, ju nuk mundemi me marr mend se krejt këto çka i them i kam te shkruajtur ne letër dhe krejt këto janë te nënvizuara dhe kur te doni mundeni me pas çasje ne dokumente publike dhe me i pae si kërkesat për me i hap qendrat e reja te vaksinimit, kërkesat për me i rrit ekipet, pastaj hemodializen. Kështu që nuk e kam ngritë asnjëherë me pak zërin sa i takon këtyre situatave sa her jemi përballur edhe për kontrate kolektive për te gjitha qeveritë duke filluar nga qeveria Thaqi që me vjen keq që është ne Tribunal të Hagës e deri te qeveria Kurti 2. Pra është gabim me nënshkrua dikush kontratë edhe me hudhë barrën komunës me pastaj komunës mos me ja dhënë mundësinë me i dhanë leje për me ju qitë pare që me i pagua mësimdhënësit, qe është gabim pavarësisht që tha me herët Sali Sallteku se komuna ju ka mbete dhe këtë e di unë që komuna ju ka mbete por pyeteni cilin do kryetar te komunave, jurist apo avokat do ju thotë se sa keq është se ju ka mbet komuna. Kështu që nëse e marrim si shembull kryetarin e Komunës se Fushe Kosovës, duhet ta dini se ai veç per leje te ndërtimit e ka buxhetin sa krejt buxheti i Komunës se Rahovecit. Pra këto kritika nuk i kam për shkak se e dua apo nuk e dua një qeveri sepse është e jona por e thash me herët dhe po e përsëris prape se ne raport me komunat, qeveria e Kosovës cilado qoftë ajo edhe qeveria aktuale nuk do te ishte mirë me i prek komunat per shkak se komuna është hallka e par e komunikimit apo adresa e parë e kontaktit me qytetare. Pra që jemi korrekt une nuk po bëj akuza, unë po shqyrtoj fakte dhe prezantoj shqetësime që i ka edhe komuna e jonë sikurse i kanë edhe komunat e tjera. Ne raport me fondet, ne raport me pandeminë i kemi me kontratën kolektive me hemodializen, me rreth rrotullimin ne Krushe te Madhe, pastaj me nënkalimin në Xerxe, pastaj me projektet që janë anuluar si subvencionet që nuk janë dhanë sivjet, kështu që kush mendon se do te jepen subvencionet sivjet ai nuk ka lidhje me realitetin faktik dhe juridik ne Kosove, për shkak se nëse mendoni se duhet me u dhanë subvencionet për bujqit pa u shpallë thirrja per aplikim atëherë kemi shkelje te rende ligjore dhe kemi vepër penale, pasi as ministri i bujqësisë nuk guxon me dhanë subvencione pa pasur thirrje per aplikim, pasi eventualisht pasi kemi gjendje nga pandemie nga 1 muaj mundet me rae ne 15 ditë. Pash nëse sot hapet atëherë krejt ky dokumentacion dërgohet ne Prishtinë, pastaj formohen komisionet që do te dalin ne terrenë dhe tek në muajin Nëntor dalin ne teren dhe ne atë kohe nuk e di se çka do te shohin, që realisht ne atë koh mund te shohin vetëm hardhi te vreshtit edhe ndonjë lakër që mund ta mbjellin ka pjesa e Krushes apo e Nagavcit dhe nuk mundet me pae dhe me vlerësuar asgjë. Pra unë po them se sivjet mundem me hap thirrjen për aplikim por paret nuk mundem me i lshue sivjet, kështu që për një vit bujqësia ne Rahovec i ka 4,407,000 euro te humbura dhe nëse kjo është e pasakte atëherë lirisht mundeni me ardhë te unë dhe ju jap me saktësinë me te madhe krejt dokumentacionin që mund ta gjeni te drejtoria e bujqësisë se sa humbim nëse nuk i marrim subvencionet apo pagesat për këtë vit. Por nëse do ti kishim marr dyfish për shkak te pandemisë siç kemi kërkuar edhe prej ish ministrit Besian Mustafa që ai ka mbërri se paku me shtie që i bien 8,814,000 euro humbje bujqësisë ne komunën e Rahovecit. Kështu që nëse nuk te vërteta këto që i thash atëherë unë tërhiqem prej fjalëve te mia dhe ka te drejt me bo padi dikush, dhe nuk kam asgjë kundër asnjë ministri veç po flasim për çështje te cilat i dimë te gjithë. Pra edhe ju Ali Zhuniqi i ke prit subvencionet ne Fortesë edhe ai tjetri ne Ratkoc apo Krushe dhe ska lidhje këtu as me parti apo me qeveri. Kështu që jemi ne shtator dhe ende nuk ka asgjë konkrete pasi ministri Peci e ka nënshkrua udhëzimin administrativ mirëpo se ka hapur ende dhe arsyen se pse nuk e ka hapur ata duhet me dhanë përgjigje. Atëherë sikur mos te ishte pandemia u deshtë me shkua me bujqit dhe makinerinë bujqësore para ministrisë se bujqësisë dhe me i than se pse nuk i jep ato para dhe ku dërgoni. Pasi duke ju marr komunave duke mos dhanë subvencionet pastaj duke

mos implementuar skemën e granteve me arsyetimin e e pandemisë. Kështu që ju kërkon punë nga komuna për rregullimin e rrugëve kanalizimeve atëherë si është mundur me i marr ato para për kryerjen e tyre.

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë. Në pyetjen e parashtruar rreth numrit të personelit arsimor të vaksinuar. Ne po e përcjellim çdo ditë numrin e vaksinuarve në sektorin e arsimit dhe deri në ditën e djeshme janë vaksinuar 710 mësindhënës me dozën e parë ndërsa me dozën e dytë është një numër simbolik apo në përqindje i bie 18.2% apo 154 që nuk janë vaksinuar. Kështu që shpresojmë që gjatë këtyre ditëve të vaksinohen edhe të tjerët pasi që viti mësimor u shty deri më 13 shtator. Kurse në lidhje me kontratën kolektive desha të bëj një lutje për të gjithë juve edhe ata që janë jurista edhe ata që nuk janë jurista, që ta lexoni nenin 46, pika 23 të kontratës kolektive dhe do ta shihni qartë se kush është përgjegjës për sigurimin e buxhetit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimin, te nderuar kolegë kuvendarë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit 01-Nr.276/2009,të datës 02.07.2010.

Isak Hoti – Faleminderit kryesues, përshëndetje për drejtorët dhe gjithë kuvendarët. Është marr një vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale me datë 02.07.2010,për firmën Likos nga Turqia me seli në Prizren, ku në pikën 4 të këtij vendimi thuhet se nëse shfrytëzuesi i tokës shtetërore në afat prej 3 viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi nuk ndërton objekte ose nuk kryen punët e konsiderueshme në ndërtimin e objektit industrial, komuna e Rahovecit do të merr vendim për iniciimin e procedurës mbi denoncimin e kontratës për dhënien e tokës shtetërore në shfrytëzim. Kështu që ne jemi të obliguar si komunë me respektue nenin 4,përkatësisht vendimin e vitit 2010,gjithashtu kryetari i komunës e ka formua një komision që kanë dalë në teren për verifikimin e gjendjes faktike të parcelës 381,në venin e quajtur kodra me sipërfaqe 11 hektar 37 ari 36 metra. Pra raportin e keni përpara, siç jeni edhe ne dijeni kompania Likos ka ushtruar padi pranë gjykatës themelore në Prishtinë departamenti për çështje ekonomike me datë 11.09.2015 për kompensimin e dëmit në shumen prej 376,215 euro. Kjo gjykatë në aktgjykimin 3EK-Nr.4/15, të datës 02.10.2017 ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, pastaj paditësi ka ushtruar padi me datë 27.10.2017 në shkallën e dytë gjykata e apelit pranë departamentit për çështje ekonomike me aktgjykim AC266/17 me 25.09.2019 kur është refuzuar ankesa e paditësit si e pathemeltë dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Paditësi me datë 14.11.2019 ka shtruar revizion gjykatës supreme dhe gjykata supreme me aktgjykimin ER-Nr.66/2019 të datës 06.02.2020 ka refuzuar të pabazuar revizionin e paditësit kundër aktgjykimit të gjykatës së apelit dhe me këtë ka përfunduar procedura kontestimore me këtë çështje juridike me datë 09.03.2020. Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06 L 092 e thotë qartë se e drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme nuk mundet të bartet në shfrytëzim të personave të tretë. Arsyeja që na ka shtye neve me shfuqizue këtë vendim, pasi kanë deshtë me bo marrëveshje me vetë me disa firma tjera pa na pyet neve dhe gjithashtu kanë deshtë me ja dhanë në shfrytëzim, gjë të cilën e e ndalon ligji me ju dhanë palëve të treta pa na pyet neve pasi edhe ashtu prona është e jona. Kështu që si rezultat i kësaj në detyrohemi me marr një vendim sot për shfuqizim të vendimit që ti krijojmë rrugë kryetarit që ju vet e autorizoni që ti merr veprimet e nevojshme për kthimin e pronës në pronësi të komunës dhe në të njëjtën kohë të shkëputet kontrata njëanshëm. Faleminderit.

Fehmi Hoxha – Faleminderit kryesues, atë që e thatë ju desha të them edhe unë pasi edhe gjykata e shkallës më të lartë ka vendosur në favor të komunës, atëherë do të ishte mirë me fuqizua edhe pse nëse më kujtohet pasi kam qenë asamblist atëherë, e kemi pezulluar vendimin që gjithashtu ishte formuar një komision i cili është deshtë me dalë në terren dhe ai ka ndërmarrë veprime të njëanshme nëpër gjykata. Kështu që ky vendim ishte i pezulluar edhe atëherë mirëpo e din shefi i zyrës ligjore që duhet të shfuqizohet kështu që edhe unë jam pro kësaj.

Sali Sallteku – Siç e tha edhe asamblisti Fehmi Hoxha, e di këtë pasi kam qenë atëherë që e kemi shfuqizua dhe gjithashtu e dimë se çfarë zone është fshati Fortesa që është një vend agrar dhe isha i pajtimit që me largua ja 300–400 metra mirëpo kemi qenë kundër të gjithë, kështu që do të ishte mirë me shfuqizua dhe mos me lanë në kompetenca as te kryetarit as të askujt pa dalë në kuvend edhe me u shfuqizua nuk guxon me ju dhanë askujt.

Kryesuesi – Faleminderit z. Sallteku, atëherë e qesim në votim pikën e tretë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ridestininimin e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 2021.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë. Procesi i ridestininimit këtë vit po e fillojmë me herët në krahasim me vitet e tjera siç e dimë çdo herë ka ndodhur në muajin tetor por ka ndodh edhe në muajin shtator. Arsyeja është se në shtator e kemi seancën e shtatorit edhe është me e ngarkuar por gjithashtu janë edhe disa arsye tjera, pasi e dimë se procesi i rishikimit të buxhetit ka kaluar në nivel qendror mirëpo në nivel lokal nuk ka ndodhur dhe janë të gjitha arsyet se në mundemi me mbajt në këtë seancë pra në seancën e gushtit. Po ashtu edhe arsye tjetër është se në si kuvend kemi marr një vendim për me i subvencionua nënat lehonat dhe në momentin kur e kemi marr vendimin nuk e kemi pasur buxhetin planifikuar dhe kemi ardh në një fazë që nuk kemi mjete të mjaftueshme për mbulimin e këtij fondi dhe ndoshta kjo është një prej arsyeve kryesore se pse e kemi qitë ridestininimin në muajin gusht. Shuma e mjeteve për bartje për ridestininim është 212,719 euro ku prej tyre 110,000 euro i kemi të hyra vetanake. Në mbledhjen e KPF-së doktori kërkoj që me dhanë edhe një arsyeshmëri se pse po barten, unë e thash arsyeshmërinë që është pjesa kryesore mirëpo të gjitha këto vërejtje në kuadër të drejtorive që janë për ridestininim janë kryesisht që ka tepricë të mjeteve me përjashtim të dy projekteve që i kemi njërin në drejtorinë e Kulturës dhe tjetra në drejtorinë e Bujqësisë, që të kultura e kemi restaurimi i objektit përkujtimor për 64 të masakruarit në Krushe të Madhe dhe kjo shumë e mjeteve bartet për shkak është se për shkak akoma nuk e kemi zgjidhë çështjen e pronës pasi prona ende është e padefinuar, që sipas ligjit për me investue atëherë prona duhet të kalojë në institucionin e komunës. Tjetër projekt është në kuadër të drejtorisë për Bujqësi që la pasur shumë probleme teknike pastaj numri i vogël i kërkesave sepse programet tona subvencionimi për shtalla janë kryesisht objektet me hapësira me të vogla ku zakonisht ka pasur kërkesa të mëdha edhe realisht ky projekt nuk ka mundur me u realizu dhe këtu kemi paraparë bartje të mjeteve. Gjithashtu e thash edhe në fillim nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ligji i financave publike me lejon të ju jap edhe këtë sqarim, pasi ligji i financave publike dhe përgjegjësi e lejon bartjen prej një fondi burimor në fondin tjetër burimor por vetëm nëse është fondi burimor i njëjtë dhe këtë rast kemi nga të hyrat vetanake 21 dhe duhet të kalojnë në fondin burimor 21 dhe për këtë arsye jemi detyruar të bëjmë disa monovrime sepse në buxhetin tonë për vitin 2021 i kemi të planifikuara mallra dhe shërbime në kuadër të hyrave vetanake të 21 atëherë këto të hyra i kemi bartur në subvencione sepse subvencionet janë të planifikuara pasi qarkorja buxhetore dhe ligji e lejon duhet të planifikohen vetëm të hyrat vetanake atëherë e kemi bërë këtë manovrim fillimisht nga mallrat dhe shërbimet në të hyra vetanake i kemi qitë në subvencione dhe nga grantet mallra dhe shërbime që janë në kuadër të shërbimeve publike i kemi mbuluar prapë mallrat d.m.th. komunalit i kemi vlerësua në bazë të analizave tona sepse do të kemi një tepricë të komunalive dhe largimi nga rreziku i suficitit të buxhetit atëherë këto mjet i bien që janë shkuar në subvencione. Nëse eventualisht keni ndonjë kërkesë apo pyetje, e keni hapësirën në dispozicionin tuaj për arsyeshmërinë e këtyre projekteve mirëpo unë kërkoj që ju ta votoni këtë pikë të rendit të ditës

Fehmi Hoxha – Ky ridestininim është i arsyeshëm dhe normal që planifikimet kur bëhen, sigurisht që ekzistojnë këto mundësi ligjore me bo ridestininim të mjeteve prej një projekti që nuk kryhet si duhet për në projektin tjetër. Mirëpo, unë kam një pyetje për drejtorinë e financave se a keni ndonjë projekt investim kapital, lënda e cila është në OSHP dhe nëse po atëherë të marrim vendim këtu dhe t'i ridestinojmë të gjitha ato mjete

sepse do të shkojnë në suficit. Janë 436 lëndë që janë në OSHP kurse ajo nuk funksionon pasi nuk ka bord dhe është jofunksional. Të gjitha ato mjete prej 436 lëndëve që janë në nivel të shtetit do të shkojnë në suficit dhe nëse kemi ne ndonjë atëherë do të ishte mirë pasi jemi duke bërë ridestinimin, që të gjitha ato mjete me i ridestinue sepse do të shkojnë në suficit në mungesë të funksionimit të OSHP-së.

Munib Durguti – Atëherë, faleminderit drejtor për të gjitha sqarimet mirëpo unë kisha kërkuar edhe një sqarim të vogël, te pika 2,4 ku thuhet bartja e mjeteve nga shërbimet publike nga fondi burimor 10, kategoria e shpenzimeve komunale të transferohen në programin zyra e kryetarit në fondin burimor 21 d.m.th. këtu kemi dallim të fondeve burimore në kategorinë e subvencioneve. A kemi të dejtë me bo bartje te tilla meqenëse ky fondi burimor ndoshta është ndonjë gabim, duhet me qenë investime kapitale kurse këtu është shënuar shpenzime komunale.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, drejtori e ceku që jam pikërisht unë që në mbledhjen e KPF-së kam thënë që në mbledhjen e kuvendit se cilat nga këto pika apo projekte që po kërkohet ridestini i mjeteve për to edhe të ndryshohen projektet, të jepet sqarimi dhe drejtori na dha disa sqarime, sepse ne shohim se janë gjithsej 11 projekte edhe këto projekte kanë kaluar edhe përmes kuvendit dhe ne i kemi mbështetur të gjitha ato edhe me buxhet dhe tash po kërkohet ridestini. Kështu që, pyetja është pse ato nuk janë realizuar, prandaj, edhe ne po kërkojmë sqarim pasi që njëherë ne i kemi votua këto projekte, shpenzim buxhetor, duhet të kemi të qartë pse ato tash po ndryshohen, Siç e ceku projekti në pikën 2, restaurimi i objektit përkujtimor për 64 masakruarit në Krushë të Madhe dhe ne kemi diskutuar dhe sigurisht që i kemi dhënë mbështetje dhe megjithëse ai e sqaroi, besoj që për të gjitha këto projekte ka sqarime të arsyeshme edhe duhet të ketë por kur jemi te ky ridestini që edhe une e marr si normal, sigurisht që ka nevojë brenda vitit të bëhen ndryshime sepse ka shumë arsye se pse ndonjë projekt nuk po realizohet. Dua t'i përmend dy projekte që çdo herë i kam përmend disa herë në kuvend, fjala është për projektin e rrugës „Dëshmoret e Pashtrikut,, në lagjen edhe ku banoj unë edhe ku është edhe ky objekt i komunës dhe projekti i dytë është hapja e rrugës se re që lidh rrugën Dëshmorët e Pashtrikut me rrugën Gëzim Hamza –Piktori, tek Palestra Sportive “Mizahir Isma” që janë projekte të kërkuara vite me radhë prej qytetareve. Pra, është një rrugë vërtetë e lënë anash e cila është e kalueshme por ka pengesa dhe dëmtime të shumta dhe nuk ka trotuar dhe që është rrugë shumë me rëndësi në qytet dhe ajo e dyta që i lidhë këto dy rrugë që mendoj që janë kërkesat dhe nevojat kryesore të banorëve të kësaj lagjeje të madhe të qytetit. Po i përmendi këto pasi që ju u deshtë me ju dhanë prioritet se paku një projekt, që ndoshta ka mundur me hy në këtë ridestini dhe me u zgjidh njëra prej këtyre kërkesave. Kështu që mendoj që po kalon mandati i kësaj qeverie dhe në këtë lagje të madhe shumë pak është investuar.

Afrim Limani – Faleminderit për pyetjet, ne pyetjen e drejtuar nga Fehmi Hoxha, ne si drejtori e financave që se bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike e këna analizuar me shume kujdes situatën dhe komuna jonë nuk ka ndonjë lëndë në OSHP që mund të sjell ndonjë rrezik. Pastaj ne pyetjen e parashtruar na Munib Durguti rreth sqarimit në mallra dhe shërbime në kuadër të shërbimeve publike, e thash edhe ne fillim se sipas ligjit të financave publike dhe përgjegjësive konkretisht qarkores buxhetore subvencionet duhet të planifikohen nga të hyrat vetanake. Kështu që ne për me mbulua këtë jemi detyruar me bo disa manovrimë, e para se kemi kategorinë e mallrave dhe shërbimeve një pjesë të mjeteve të planifikuara nga të hyrat vetanake për mallra dhe shërbime sepse ligji e përcakton qartë mjetet duhet të barten po nga ai fond burimor dhe tash rasti konkret të hyrat vetanake e kanë numrin 21 ,kështu që nga 21 në 21 dhe nga granti 10 në 10.Kështu që për këtë arsye jemi detyruar me bo manovrimë, pikërisht mallrat dhe shërbimet që i kemi nga të hyrat vetanake me i qitë në subvencione zyra e kryetarit sepse zyra e kryetarit i mbulon edhe atë pjesë të subvencionimit të lindjeve atëherë këto mjete i kemi marr nga fondi 10 pra nga shërbimet publike dhe i kemi qitë në kuadër të administratës, pra veten ndërrim të pozicioneve apo vendeve që kemi bërë. Pra doktor tani ti dhashë vetëm dy sqarime duke pasur parasysh edhe kohën që mos me ju rëndua edhe juve, ju dhashë vetëm dy sqarime kryesore

se pse është bërë bartja e mjeteve jo nga teprica por si rezultat i problemeve tjera siç e potencova rastin e shtëpisë në Krushe të Madhe që ka probleme me pronën ndërsa të Kultura kemi bartje të mjeteve në kuadër të projekteve ku fillimisht ka pasur mbetje të mjeteve me shumën prej 121,170 ndërtimi i QMF-së në Opterushë dhe drejtorja e shëndetësisë e ka vlerësuar duhet me mbulue projektin e AMF-së në lagjen e epërme. Pastaj të Bujqësia siç e diskutova pasi edhe prej bujqësisë kemi marr subvencione, pastaj të planifikimi urban dhe mjedisit, ndërtimi i busteve mjetet janë tërhequr nga projekti, si ndërtimi busteve të dëshmoreve dhe janë ridestinuë në hartimin e projekteve në shumën prej 10,000 euro. Pra edhe këtu kemi pasur mbetje të projekteve sepse ndërtimi i busteve ato ndërtohen në bazë të kërkesave të familjareve dhe në bazë të kërkesës së shoqatës së dalur nga lufta, kështu që realisht nuk kemi pasur ndonjë kërkesë dhe kjo pjesë e mjeteve ka ngelur edhe e kemi bartur në kuadër të këtij projekti. Pastaj e kemi nga drejtorja për ekonomi dhe zhvillim, investimi në zonën ekonomike në Opterushë 15,000 që i kemi bartur në intervenime emergjente në infrastrukture, pasi e dimë që ndërtimi i zonës ekonomike në Opterushë faza e parë e ndërtimi të projektit ka përfunduar dhe realisht kjo është shumë simbolike e mjeteve për me fillua ndërtimi i fazës së dytë duke ditur që këtu kërkohej ndoshta edhe miliona dhe atëherë kemi vlerësuar me se miri që këto mjete të ridestinojmë në kuadër të një projekti tjetër. Kështu që sa për dijeninë e juaj ministria industrisë dhe tregtisë ka një projekt që ka bërë thirrje që i financon të gjitha komunat e Kosovës dhe në si komunë kemi aplikue aty dhe presim që të na realizohet ajo kërkesë, që në fakt në kemi kërkuar 1 milion euro që të paktën bilëm 500,000 me të lëshue do të ishte mirë. Gjithashtu kemi edhe një projekt në kuadër të shërbimeve publike ndërtimi i rrugës Rahovec-Pataqan me shumën prej 35,000 euro, edhe këtu e kemi ndërpre kontratën me kusht që me fillue kontratën e re, që edhe këto mjete i kemi vlerësuar se duhet të ridestinohen në kuadër të këtij projekti.

Fehmi Hoxha – Rreth busteve, janë shpallur fituesit që janë dy bustet dhe kontrata pritët me u nënshkrua me vlerë rreth 15,000 euro, kështu që dy buste janë krye, mos po i largojmë ato mjete mirëpo ato dy buste me çka doni me i pagua, pasi dy bustet kanë përfunduar dhe janë shpallur fituesit që vlera për dy bustet është 15,000 euro. Pra a ka mjete edhe për ato apo kanë teprua dhe po i bartni diku tjetër.

Kryesuesi – Faleminderit z.Hoxha, atëherë e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë. Megjithatë e kemi të gjithë materialin, unë nuk do të ndalem që me analizue materialin por nëse keni ndonjë pyetje konkrete unë do të përgjigjem dhe po ashtu edhe në mbledhje të KPF-së keni kërkuar disa pyetje dhe kemi dhënë sqarime por do të jemi këtu bashkërisht nëse keni diçka rreth temës lidhur me investimet në hapësirat publike do të jemi këtu që të ju përgjigjem.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për informatën, meqenëse nuk kemi tjerë të lajmëruar, atëherë unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoj 11:45

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

